



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.653/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkritazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021 mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.653/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

Më datë 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.653/2021 të datës 18.10.2021, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë në të cilat pretendon se Avni Fetahu, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje në ditën e zgjedhjeve me datë 17.10.2021, përmes rrjetit social Facebook ka sponsorizuar një postim me anë të cilit ka kërkuar nga qytetarët që ta votojnë duke ndikuar kështu në mënyrën e votimit, andaj me këtë postim kandidati Avni Fetahu ka tejkaluar periudhën kohore për fushatë zgjedhore. Në mbështetje të pretendimeve të tyre Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka bashkangjitur si dëshmi fotografi të printuar të shkeljes së supozuar sipas ankesës.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me Planin Operacional për Organizmin e Zgjedhjeve Lokale, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullën Zgjedhore 13/2013. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar në cilësi të provave materiale.

PZAP, më datë 18.10.2021 i ka paraqitur Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën Anr.653/2021 me të cilën ka kërkuar që të përgjigjet deri më datë 19.10.2021 në ora 09:00.

Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me datë 18.10.2021 ka paraqitur pranë PZAP-së përgjigje në ankesë me të cilën i ka kundërshtuar pretendimet e ankuesit duke theksuar se ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të qarta dhe bindëse që vërtetojnë faktin se me çfarë datë dhe në çfarë kohe kandidati Avni Fetahu, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës e ka shpërndarë materialin zgjedhor të pretenduar si në ankesë. I ka propozuar Panelit të PZAP-së që ankesën ta refuzojë si të pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se

Ankesa është e pabazuar

Paneli, pas shqyrtimi të shkresave të lëndës dhe konfrom nenit 8 par.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, me datë 18.10.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara ngase në kohën e ekzaminimit të kësaj shkeljeje të pretenduar postimi i kontestuar në ankesë gjendej në faqen e tij në Facebook mirëpo i njëjti ishte publikuar me datë 15 tetor 2021 në ora 21:59 që nënkupton se nuk është thyer heshtja zgjedhore sepse postimi ishte i publikuar para periudhës së heshtjes zgjedhore dhe i njëjti nuk ishte i sponsorizuar në ditën e votimit ashtu siç pretendohet në ankesë.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësi i supozuar me datë 17.10.2021, e ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se postimi i shkelësit të supozuar është publikuar apo ka vazhduar sponzorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e votimit, edhe pse parashtruesi i ankesës ka paraqitur fotografi me të cilat pretendon se postimi i sponzorizuar ka qenë aktiv në ditën e votimit, paneli këto pretendime nuk mundi ti vërtetoj sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e postimit të shkelësit të supozuar siç pretendohet në ankesa.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.653/2021 më datën 20.10.2021



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*